

AKTI I THEMELIMIT
DHE
STATUT I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
SRT-MG SHPK

Në këtë statut

-“Ligji” është Ligji Nr.9901, dt.14/04/2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë tregëtare” i ndryshuar;

-“Statuti” është Statut i shoqërisë;

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

1. Sot, më 10.08.2023, (Dhjetë Gusht 2023), ne themeluesit **Merita Tanushi**, dhe **Geraldo Laço** kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin SRT-MG SH.P.K.
2. Themeluesi i shoqërisë është:
Merita Tanushi, lindur në Hebe Mirditë, Shqipëri më 24.11.1988, banues në Tiranë, Njësia Bashkiake Nr.4, Rruga 5 Maji, rrugica Kamber Shevroja, banesa nr. 3, dhe **Geraldo Laço**, lindur në Çorrovodë më 15.08.1987, banues në Tiranë, Njësia Bashkiake Nr.4, Rruga 5 Maji, rrugica Kamber Shevroja, banesa nr. 3, Tiranë.

Neni 2:

Objekti


Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Objekti kryesor i veprimtarisë, ka të bëjë me instalime, meremetime, mirëmbajtje, riparime e shërbime elektrike e hidraulike, kondicionim të ambjenteve të banimit, të shërbimeve, të zyrave etj., shërbime të ndryshme informatike, implemetimin dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese te energjisë elektrike me elemente fotovoltaike dhe gjithë llojeve të tjera të prodhimit të energjisë, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, në fushën e teknologjisë së informacionit dhe konsulenca në lidhje me aplikimin e teknologjisë së informacionit, në fusha te ndryshme.

Blerja, importimi dhe shitja e HARDËARE-ve, për përdorim në fushën e teknologjisë së informacionit, zhvillim dhe shitje të programeve kompjuterike, për përdorim nga entitetet në fusha të ndryshme, përgatitje dhe zbatim plan-biznesi.

Pastrami i zyrave, rrugëve, shesheve dhe ambjenteve sociale.

Komisjoneri e shërbime të tjera, ofrimi i shërbimeve të konsulencës për shoqëritë e kontrolluara prej saj dhe/ose tjetretë (të cilët përfshijnë pa kufizime konsulencën e natyrës financiare, menaxheriale, ligjore, IT, zhvillim të softëve etj) në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj. Gjithashtu, shoqëria mund të kryejë çdo veprim, operacion apo transaksion tjetër komercial, industrial e financiar, të dobishëm apo plotësues ndaj përmbushjes së objektit të shoqërisë, me kusht që aktivitetet e mësipërme të mos jenë në kundërshtim dhe të mos alterojnë objektin parësor të veprimtarisë së shoqërisë.



Neni 3:

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë kohore të papërcaktuar.

Shoqëria e fiton personalitetin e saj juridik, pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 4:

Selia

1. Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: **Njësia Bashkiake Nr.4, Rruga 5 Maji, rrugica Kamber Shevroja, banesa nr. 3, Tiranë.**
2. Adresa e faqes së internetit të shoqërisë është: srtmg.bussines@gmail.com
3. Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: srtmg.bussines@gmail.com

Kreu II

Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

1. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 10.000 (dhjetë mijë) lekë.
2. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
 - a. Ortaku themelues Merita Tanushi, zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 7.000 (shtatë mijë) lekë, që përbën 70% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - b. Ortaku themelues Geraldo Laço, zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 3.000 (tremijë) lekë, që përbën 30% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kometente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.


Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila mer vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:



- a. kontributi në kapitalin e shoqërisë;
- b. shitblerjes;
- c. trashëgimisë;
- ç. dhurimit;
- d. çdo menyre tjetër të parashikuar nga ligji.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transmetueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut. Pjesët e kapitalit themeltar janë lehtësisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarrës

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a. Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b. Ndryshimet e statutit;
- c. Emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d. Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e. Përcaktimin e shpërblimeve të personave të përmendur në shkronjat (c) dhe (d) të kësaj pike;
- f. Mbikqytjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- g. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- h. Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i. Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j. Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k. Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l. Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;
- m. Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.



Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithëshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim të postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithëshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakort, për të marrë vendime pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e vendimarrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithëshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 përqind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithëshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të kuotave, janë të pranishëm personalisht, të votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikes 3, të nenit 88, të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithëshme mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lartë, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithëshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithëshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesmarrës, për çështje të tjera si:

- a. Përcaktimi i politikave tregëtare të shoqërisë;
- b. Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c. Emërimin e shkarkimin e likujduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d. Përcakimin e shpërblimeve;
- e. Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregëtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f. Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g. Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 12

Përfashtimi nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithëshme merr vendim për:
 - a. Vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b. Shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c. Ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - d. Dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si edhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

1. Asambleja e përgjithëshme emëron një ose me shumë persona fizik si administrator të shoqërisë. Afati iemërimit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
2. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administrator të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
4. Administratori i shoqërisë SRT-MG shpk emërohet MERITA TANUSHI, lindur në Hebe Mirditë, Shqipëri më 24.11.1988, banues në Tiranë, Njësia Bashkiake Nr.4, Rruga 5 Maji, rrugica Kamber Shevroja, banesa nr. 3, Tiranë, që e fillon aktivitetin e administrimit menjëherë pas regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
3. Administratori i shoqërisë SRT-MG shpk emërohet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me të drejtë riemërimi nga Asambleja e Përgjithëshme.


Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

Administratori ka të drejtë e detyrohet:

- a. Kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithëshme;
- b. Përfaqëson shoqërinë tregtare;
- c. Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave e të librave kontabël të shoqërisë;
- d. Përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithëshme për miratim;
- e. Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f. Kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, sic parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- g. Raporton përpara asamblesë së përgjithëshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h. Kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe statut.

Administratori është detyruar të thërrasë Asamblesën e Përgjithëshme, në rastet kur :



- Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme finaciare, rezulton ose ekziston rreziku se aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- Shoqëria propozon të shesë apo të disponoje në mënyrë tjetër aktivet, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë që rezultojnë në pasqyrat e fundit finaciare të çertifikuara.
- Shoqëria, brenda dy viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat finaciare të çertifikuara.

Nëse Asambleja e përgjithëshme emëron mëshumëse një administrator, ata e administrojnë së bashku shoqërinë.

Asambleja e përgjithëshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

Paditëqë lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja qëi sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

- A. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithëshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14; 15; 17 e 18 të ligjit “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”, administratori detyrohet;
 1. Të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 2. Të ushtrojë kompetencat qëi njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita ;
 3. Të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendimi;
 4. Të parandalojë dhe mënjanë rastet e konfliktit, present apo të mundshëm, të interesave personalë me ato të shoqërisë;
 5. Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe me kujdesin e nevojshem.
- B. Administratori gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për cdo veprim ose mosveprim që lidhet në mënyrë të arsyeshme me vetë qëllimet e shoqërisë tregëtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprime ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- C. Nëse administatorit vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave A dhe B të këtij neni, është i detyruar ti shpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe ti kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të pa rregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standarteve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.
- D. Në mënyrë të veçantë por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar ti dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”, kryen veprimet e mëposhtme:
 - a. U kthen ortakëve kontributet;
 - b. U paguan ortakëve interesa apo dividend;
 - c. U shpërndan aktivet shoqërisë;

- d. Lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregëtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese që të shlyejë detyrimet;
- e. Jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit qëi mgarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund tëë ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë kryerjes së detyrës.

Kreu IV

Viti financiar-ekspertët

Neni 16

Viti Financiar

Viti financiar i shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përrjashtimisht, viti ipare financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike tregëtare të shoqërisë, atë gjithë vjetore dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillëingarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat ështëi detyruar t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që kanë.

Kreu V

Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja dhe prishja eshoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a. Kur mbaron kohëzgjatja parashikuar në themelimin e saj;
- b. Me vendim të asamblese së ortakëve;
- c. Me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d. Nëse nuk ka kryer veprimtari tregëtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3, të nenit 43, të ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007, për “Qendrën Kombëtare të Biznesit”
- e. Me vendim të gjykatës.

Në këtë rast ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”.

Prishja e shoqërive tregëtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likudjimi kryhet nga likudjuesit e emëruar nga ortakët. Nëse ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likudjuesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund të drejtohet gjykatës, për të caktuar një likudjues.

Neni 19

Riorganizmi i shoqërisë, bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet, sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithëshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në pjesën IX të Ligjit 9901, datë 14.04.2012, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare".

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregëtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKËTE SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

SRT-MG SHPK

MERITA TANUSHI | GERALDO LAÇO

Merita Tanushi *Geraldo Laço*

Tiranë, më:10/08/2023.